



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 29.07.2009, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e shteteve arabe.

Delegacioni i shteteve arabe ishte në përbërje: z.Alaa Makki Abdul Razzak -deputet nga Grupi Suni në Parlamentin e Irakut, z.Gamal Zahran - deputet në Parlamentin e Egjiptit, z.Oraib (Mohto Raja) Mohammad Altrawi-drejtor i Qendrës AL-Quad, z.Muhamed Mufaku- profesor në Universitetin e Jordanit dhe z.Sami Reka- zyrtar nga Klubi për Politikë të Jashtme.

Në takim nga Komisioni morën pjesë: z.Xhavit Haliti, z.Ramë Buja, z.Eqrem Kryeziu, z.Lutfi Haziri, z.Ibrahim Gashi, z.Ardian Gjini dhe z.Dragisha Miriq.
Munguan: z.Sabri Hamiti, z.Enis Kervan, z.Ramadan Avdiu dhe z.Nexhat Daci .

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin të pranishëm: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Ilaz Rudaku.

Mbledhjen e kryesoi : Xhavit Haliti-zëvendës kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Takim me delegacionin e shteteve arabe.

Xhavit Haliti shprehu kënaqësinë për praninë e delegacionit arab në Kosovë dhe fillimisht i njoftoi për përbërjen e Komisionit për Punë të Jashtme.

Duke pasur parasysh se Parlamenti i Kosovës është ndër më të rinjtë në botë, tha se po bëjmë përpjekje që të kemi sa më shumë miq dhe të krijojmë raporte miqësore me ato shtete e ata popuj me të cilët kemi lidhje të shumta .

Dilemat lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës duhet hequr dhe duhet të ndërtojmë lidhje ekonomike, e investime në Kosovë nga shtetet e Lindjes së Mesme. Ne kemi bërë përpjekje që përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, të ndikojmë drejtpërsëdrejti në njohjen e pavarësisë së Kosovës nga vendet arabe. Disa shtete e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, presim që edhe shtete të tjera ta njohin. Tani është mirë që është hapur një rrugë komunikimi, e cila që më parë ishte e pamundur për shkak të vështirësive tuaja, të cilat besojmë se do të tejkalohen.

Alaa Makki Abdul Razzak tha se ishte shumë i kënaqur që gjendej në Kosovë, në një vend me shumicë myslimane. Qëllimi i vizitës sonë është hapja e një faqeje të re të

marrëdhëniet ndërmjet nesh, së pari në formë zyrtare - ndërmjet parlamenteve, pastaj ne do të punojmë për njohjen e Kosovës edhe në nivelet më të larta. Ai e njoftoi Komisionin për situatën në Irak, ndërtimin e sistemit demokratik, i cili e përfaqëson gjithë popullin e Irakut. Ndër të tjera tha se është një disponim i përgjithshëm i popullit irakian për njohjen e Kosovës, që është faktor ndikues në marrjen e një vendimi politik për Kosovën.

Gamal Zahran shprehu kënaqësinë për vizitën që po i bëjnë Kosovës dhe për takimin me anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme. Populli i Egjiptit është shumë i kënaqur për pavarësinë e Kosovës dhe do të bëjmë atë që është e mundur së bashku me kolegët parlamentarë, për ta nxitur kryetarin e Parlamentit Egjiptian për përkrahjen e pavarësisë së Kosovës. Çështjen e Kosovës do ta ngreme edhe te ministri i jashtëm dhe do të kërkojmë nga ai, shkaqet dhe arsyet për mosnjohjen e Kosovës deri më tani. Çështja e pavarësisë së Kosovës do të jetë pikë e parë që do të diskutohet në mbledhjen e Parlamentit Egjiptian. Ne presim të vini së shpejti në Egjipt dhe ndërkohë do t'i pranojmë pasaportat e reja të shtetit të Kosovës.

Oraib (Mohto Raja) Muhammad Alratawi tha se ndiente kënaqësi që gjendej në Parlamentin e Kosovës dhe shtoi se kjo vizitë është në vazhden e vizitave që do të vazhdojnë për ta njohur shtetin e Kosovës. Kërkoj të informohej për sistemin demokratik të zgjedhjes së deputetëve të Parlamentit të Kosovës.

Xhavit Haliti lidhur me sistemin zgjedhor tha se pas luftës e kemi pranuar një sistem në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare. Në dy legjislaturat e kaluara kemi pasur sistem proporcional me lista të mbyllura. Gjithsej kemi 120 deputetë, prej tyre 20 vende janë të rezervuara për pakicat, 10 për komunitetin serb dhe 10 vende janë për komunitetet e tjera. Po ashtu tha se në Kuvend janë të rezervuara 30 % e vendeve për gratë.

Ramë Buja përshëndeti delegacionin dhe shtoi se ndihet mirë që i takon kolegët deputetë nga shtetet mike, si dhe për qëndrimin e tyre për pavarësinë e Kosovës, qëndrim i cili do të ndikojë në botën arabe për ta njohur pavarësinë e Kosovës.

Lutfi Haziri tha se populli i Kosovës pritjet më të mëdha për njohje i ka pasur nga shtete arabe dhe fillimi me Arabin Saudite, Jordaninë dhe Bahreinin do të hapë rrugë që edhe shtetet si Egjipti e Iraku ta njohin shtetin e Kosovës. Ne i kuptojmë vështirësitë dhe problemet që kanë dalë për pranimin e Kosovës, por realisht është pritur një reagim më i madh i shteteve mike arabe, që do të na ndihmonte dhe do të ndikonte shumë në proceset që po kalon Kosova. Duke e ditur rolin tuaj në mekanizmat që ju përfaqësoni dhe ndikimin në shtetet mike, kërkoj nga ju të na ndihmoni të ecim përpara bashkërisht me zhvillimet në Kosovë.

Ardian Gjini shprehu kënaqësi për praninë e delegacionit arab në Kosovë dhe tha se duke e parë disponimin tuaj, kërkoj të na ndihmoni personalisht, që të ketë sa më tepër njohje të Kosovës nga vendet arabe. Neve na duhet një rrugë komunikimi me njerëzit me ndikim në vendet tuaja, në mënyrë që të ndikojmë në parlamentet dhe qeveritë e vendeve arabe, që sa më shpejt ta njohin pavarësinë e Kosovës.

Eqrem Kryeziu nderoi mysafirët nga bota arabe dhe shprehu kënaqësinë për premtimet e tyre se do të punojnë për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Ibrahim Gashi përshëndeti mysafirët dhe tha se ju përfaqësoni një regjion shumë të rëndësishëm për Kosovën, dhe se është një histori e gjatë e lidhjeve tona kulturore, religjioze e akademike. Kjo vizitë konfirmon fillimin e lidhjeve institucionale të Kosovës me vendet arabe. Kërkojmë nga ju që të pasqyroni realitetin e ri që mbretëron në Kosovë dhe të ktheheni andej me bindjen se duhet mbështetur Kosovën në rrugën e njohjes nga vendet tuaja.

Dragisha Miriq i dëshiroi mirëseardhje delegacionit nga vendet arabe. Në vazhdim tha se situata në mes të shqiptarëve dhe serbëve, është përmirësuar mjaft. Ne të gjithë së bashku po punojmë që raportet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të përmirësohen, dhe dëshiroj që në të ardhmen të jetojmë ashtu siç kemi jetuar më parë.

Muhamed Mufaku falënderoi Komisionin për pritjen e bërë dhe tha se me përkrahjen e shoqërisë civile në Aman dhe më pas në Prishtinë janë mbajtur konferenca në mbështetje të pavarësisë, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në njohjen e Kosovës nga Jordania. Po ashtu tha se është koha të bëhen përpjekje që marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe vendeve arabe të ngriten në nivele institucionale .

Xhavit Haliti falënderoi mysafirët për vizitën dhe shtoi se ky takim është me rëndësi sepse do të ndikojë në raporte të mira ndërmjet parlamenteve dhe komisioneve simotra të vendeve arabe. Ky takim njëkohësisht do të ndikojë të gjenden rrugë dhe mundësi që të takohemi edhe në vendet tuaja, qoftë në nivele parlamentare apo me shoqërinë civile për të ndërtuar raporte institucionale që do të jenë në shërbim të popujve tanë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetje të Komisionit

Zëvendëskryetari i Komisionit

Xhavit Haliti